



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 98, Datë 04.07.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË DHE MIRATIMIN E EMËRIMIT TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË PROPOZUAR NGA OST SH.A.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “ Për sektorin e energjisë elektrike”, Vendimit të Bordit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të Certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.”, neni 21 i Direktivës së Energjisë Elektrike 2009/72/EC, neni 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë, të përgatitur nga Drejtoritë teknike të ERE,

Konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a. me shkresën nr. 3092 prot., datë 05.06.2017, paraqiti pranë ERE kërkesën për miratimin e Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë “OST” sh.a., me anë të të cilit ka emëruar zyrtarin e Pajtueshmërisë, si dhe ka miratuar kontratën e ofrimit të shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë midis OST sh.a. dhe zyrtarit të pajtueshmërisë.
- ERE me Vendimin e Bordit nr. 43, datë 15.03.2017, ka vendosur “Mbi miratimin përfundimtar të Certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”.
- Kërkesa e shoqërisë “OST” sh.a., për miratimin e kontratës së ofrimit të shërbimeve të zyrtarit të Pajtueshmërisë, daton 05.06.2017 dhe është në zbatim të kushteve dhe afateve të parashikuara në Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të Certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.” dhe në përmbushje të detyrave të caktuara nga Direktiva 2009/72/EC.

- ERE ka kompetencën për të miratuar Kontratën e Zyrtarit të Pajtueshmërisë.
- Shoqëria “OST” sh.a. nëpërmjet organeve të saj drejtuese ka të drejtën të porpozojë për miratim në ERE, zyrtarin e pajtueshmërisë së zgjedhur nga këto organe.
- Kontrata e zyrtarit të pajtueshmërisë në shtojcën 2 të saj, ka listuar kushtet që duhet të përmbushë zyrtari i pajtueshmërisë.
- Shoqëria “OST” sh.a. në shkresën e saj nr. 3092 prot., datë 05.06.2017, nuk ka bërë me dije në lidhje me përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në shtojcën 2 të draft kontratës nga zyrtari i përzgjedhur dhe emëruar nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë,

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e Kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të zyrtarit të pajtueshmërisë të propozuar nga Shoqëria “OST” sh.a..
2. Shoqëria “OST” sh.a. të dokumentojë plotësimin e kriterëve të përcaktuara në shtojcën 2 të draft kontratës nga zyrtari i propozuar për miratim.
3. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI